

sagemax[®]



Udhëzimet e përdorimit



NexxZr.[®]
Glaze Spray

sagemax.com

Pasqyra e lëndës

Informacioni i produktit	03
Materialet përbërëse	04
Udhëzimet e përdorimit	04
Parametrat e djegies	06

Informacioni i produktit

"NexxZr® Glaze Spray" është qeramikë silikati litiumi e gatshme për përdorim dhe me vendosje të lehtë për lëmimin e sipërfaqeve të restaurimeve monoblok prej oksidi zirkoni. Sipërfaqe nuk është e nevojshme të përgatiten në ndonjë mënyrë përpara përdorimi; nuk nevojitet ngjitëse, solucione dhe djegie paraprake përpara veshjes së sipërfaqeve të restaurimit me "Sagemax NexxZr Glaze Spray". Pjesët me oksid zirkoni duhen pastruar e u duhen hequr pluhuri e yndyra për të siguruar një shtresë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe. "NexxZr Glaze Spray" është i përshtatshëm për të gjitha materialet me oksid zirkoni.

Indikacioni

"NexxZr Glaze Spray" është vetëm për përdorim ekstraoral.

- › Këllëfët
- › Inleiet
- › Onleiet
- › Këllëfët e pjesshëm dhe urat në zonën e parme dhe anësore të dhëmbit

Kundërindikacionet

- › Vendosja mbi zirkone në gjendje të paaglomeruar
- › Vendosja në qeramikë me pikë të ulët shkrirjeje
- › Vendosja intraorale

Efektet anësore

Nuk ka efekte të njohura anësore. Në rast alergjie të ditur ndaj njërit prej përbërësve, përdorimi i "NexxZr Glaze Spray" duhet evituar.

Respektoni udhëzimet në etiketën e kënaçes spërkatëse

- › Aerosol i djegshëm
- › Ena ndodhet nën presion: mund të shpërthejë nëse ekspozohet ndaj nxehtësisë
- › Shkakton irritim të rëndë të syve
- › Mbajeni larg nxehtësisë, sipërfaqeve të ngrohta, shkëndijave, flakëve të lira dhe llojeve të tjera burimesh ndezjeje
- › Mos pini duhan
- › Mos e spërkatni në drejtim të flakëve të lira apo burimeve të tjera të ndezjes
- › Mos e shponi apo digjni, as pas përdorimit
- › Mbani doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtëse për sytë/maskë

- › Në rast irritimi të vazhduar te sytë: kërkoni këshillën/ndihmën e mjekut
- › Mbrojeni nga drita e diellit
- › Mos e ekspozoni në temperatura mbi 50°C
- › Respektoni fletën tonë të sigurisë teknike

Udhëzimet e përgjithshme të punës

"NexxZr Glaze Spray" synohet ekskluzivisht për përdorim në laboratorët dentarë nga personel i trajnuar.

- › Përdoreni vetëm në ambiente të mirajruara.
- › Mos e thithni vesën e spërkatëses.
- › Mbani maskë mbrojtëse dhe përdorni njësi thithëse të përshtatshme për ambientin e punës.
- › Nuk lejohet për përdorim intraoral.
- › Ena me aerosol është nën presion dhe duhet mbrojtur nga drita e diellit dhe temperaturat mbi 50°C.
- › Mos pini duhan.
- › Mbajeni larg burimeve të ndezjes.
- › Mos e spërkatni në drejtim të flakëve të hapura (p.sh. vatrat "Bunsen") apo mbi sipërfaqe të nxehta.
- › Ruajeni në një vend ku nuk arrihet nga fëmijët.
- › Pas përdorimit mos e hapni me forcë dhe mos e digjni.
- › Zbrazeni gjithnjë plotësisht kënaçen spërkatëse.



Informacion i rëndësishëm

Kënaçet spërkatëse "NexxZr Glaze Spray" ruajini gjithnjë në temperaturë ambienti. Përdoreni "NexxZr Glaze Spray" në temperaturë ambienti prej 15-35°C. Temperaturat shumë të larta apo të ulët të ambientit cenojnë rezultatin e spërkatëses. Përdoreni spërkatësen vetëm në ambiente të mirajruara, përdorni sisteme të përshtatshme thithëse dhe mbani maskë mbrojtëse ndaj pluhurave për t'u mbrojtur nga spërkatësja e imët. Sigurohuni që ta përdorni spërkatësen në ndriçim të mirë, që të mund të shikoni nëse restaurimi është veshur njëtrajtshëm dhe në tërësi.

Materialet përbërëse

Lëndë djegëse (Solstice HFO 1,2,3,4 ze), solucion (izopropanol) dhe përzierje pluhuri qeramik dentar.

Udhëzimet e përdorimit

Përpara përdorimit fillestar

Përpara përdorimit fillestar, testojeni spërkatësen fillimisht në një panel xhami. Sigurohuni të spërkatni në distancën e duhur prej rreth 15-20 cm nga objekti. Me lëshime të shkurtra të spërkatjes do të arrini një vendosje optimale të shtresës. Përdorni vetëm kokën e dhënë spërkatëse. Njollat e njoma apo që kullojnë janë tregues se distanca e spërkatjes është shumë e ngushtë. Nëse ka depozitime të pabarabarta të pluhurit do të thotë se keni spërkatur më shumë se ç'duhet ose kënaqja nuk është tundur mjaftueshëm duke mos e përzier plotësisht pluhurin.

Hapi 1:

Përpara vendosjes për herë të parë të kokës spërkatëse, tundeni intensivisht kënaçen e spërkatëses për të aktivizuar përbërjen spërkatëse, në mënyrë që grimcat qeramike të përzihen plotësisht me lëngun përzierës brenda kënaçes. Sferat përzierëse mund të dëgjohen qartë pas vetëm pak sekondave, por gjithsesi vijoni ta tundni fort kënaçen e spërkatëses për 1 minutë.

Hapi 2:

Tani vendosni kokën spërkatëse me shtizën spërkatëse dhe tundeni sërish për pak. Spërkatësja tani është gati për përdorim. Pas periudhave të shkurtra të mospërdorimit, tundeni sërish kënaçen spërkatëse duke përdorur lëvizje rrethore. Kjo procedurë është thelbësore. Një përgatitje e mirë siguron rezultate optimale spërkatjeje dhe parandalon problemet me hundëzat, tubat dhe sistemin e valvulave.

Përgatitja e restaurimit me oksid zirkoni

Për të arritur rezultate optimale të sipërfaqes, restaurimi i aglomeruar dhe formuar plotësisht i oksidit të zirkonit duhet të jetë i thatë, i pastër, pa pluhur e yndyrë. Për mbulimin e sipërfaqes nevojitet vetëm një vendosje e pakët me "NexxZr Glaze Spray". Sidomos në rastin e restaurimeve të

plota anatomike monoblok, tiparet funksionale dhe estetike, si p.sh. sipërfaqet okluzale, pikat e kontaktit, gradienti i ngjyrës dhe efektet individuale, duhen marrë parasysh përpara se të aglomerohet oksidi i zirkonit. Sipërfaqja okluzale, marzhet e këllëfit dhe forma marzhinale thuajse nuk ndryshohen fare nga një vendosje e vetme. Ne rekomandojmë ta vendosni "NexxZr Glaze Spray" vetëm pas provës dentare dhe kryerjes së korigjimeve të nevojshme.

Teknikat e spërkatjes

Gjatë përdorimit mbajeni kënaçen spërkatëse në pozicionin drejt në këmbë sa të mundeni. Ndryshe nga vendosja e llakut, "NexxZr Glaze Spray" rekomandohet ta vendosni me spërkatje të shkurtra. Në këtë mënyrë, shpërhapen vetëm sasi të vogla pluhuri, njëherësh sistemi i hundëzave vetëpastrohet gjatë kësaj procedure.

Trashësia e shtresës

Vendoseni spërkatësen në mënyrë që sipërfaqja e zirkonit të vijojë të shkëlqejë përmes pluhurit të bardhë. Lëngu bartës avullon krejtësisht pas pak sekondave dhe lë një shtresë të hollë pluhuri që ngjitet më së miri me sipërfaqen dhe nuk rrëshqet.

Zgjidhja e problemeve

Pjesët e keqspërkatura mund të lahen lehtë me ujë ose të pastrohen me avull, e njëjta vlen dhe në rast se vendoset shumë material.

Pas tharjes me kompresor, "NexxZr Glaze Spray" mund të spërkatet sërish. Nëse zona të vogla dëmtohen gjatë punës me restaurimet e spërkatura dentare, këto mund të rispërkatën sërish hollë.

Djegia e qeramikës

Kryejeni djegien qeramike sipas udhëzimeve (parametrat e djegies) për "NexxZr Glaze Spray". Gjatë djegies së qeramikës, komponentët e dioksidit të zirkonit dhe "NexxZr Glaze Spray" difuzohen së bashku pranë sipërfaqes për të krijuar një ngjitje të fortë kur ftohen. Njëherësh krijohet një sipërfaqe e lëmuar.

Djegia e difuzionit

Nëse spërkatësja është vendosur saktë, do të arrini një cilësi sipërfaqeje të fortë, të lëmuar dhe homogjene me një ngjitje optimale ndaj oksidit të zirkonit që pas djegies së parë.

Përdorimi i ngjyrosjes

"NexxZr Glaze Spray" është një lustër universale, transparente e shtresëhollë. Mund të përdoret ose vetëm ose në kombinim me ngjyra shkrirjeje të lartë dhe materiale qeramike. Nëse restaurimi duhet individualizuar me ngjyrosje, këto bëhen menjëherë pas djegies së 1^{re} (djegia e difuzionit).

Djegia e individualizimit

Pas tharjes së ngjyrave restaurimi spërkatet sërish hollë me "NexxZr Glaze Spray" dhe pastaj digjet edhe një herë të dytë (djegia e individualizimit). Pas kësaj djegieje, sipërfaqja duhet të jetë e shndritshme, pa pore dhe homogjene. Gjatë djegies së dytë, kohët e mbajtjes mund të shkurtohen për të reduktuar stresin termik mbi ngjyrosjet.

Rekomandimet alternative për djegien

Për furrat më të vjetra qeramike kemi përfshirë një program të thjeshtuar djegieje me një normë nxehtësie, që ka rezultuar i dobishëm për shumë klientë.

Zgjidhja e problemeve

Pas tharjes së ngjyrave restaurimi spërkatet sërish hollë me "NexxZr Glaze Spray" dhe vijon djegia e 2^{re} (djegia e individualizimit). Nëse duken pore të vogla në sipërfaqe pas djegies, kjo ndodh zakonisht për shkak të vendosjes shumë të pakët të pluhurit. Spërkateni sërish restaurimin, pa ndonjë trajtim shtesë të sipërfaqes, dhe digjeni sërish. Kontrolloni parametrat e djegies dhe/ose kalibrimin e furrës.

Pastrimi

Pas përdorimit të kënaçes spërkatëse, pastrojeni menjëherë kokën spërkatëse (p.sh. duke e shpëlarë me ujë të vakët dhe duke e pastruar me kompresor, nëse është nevoja, edhe me banjë me ultratinguj). Në vijim thajeni kokën me kompresor e ajrit pa vajra.



Këshillat për dentistin

Gjatë një trajtimi pastrues profesional (profilaksi), sipërfaqet e trajtuara me "NexxZr Glaze Spray" nuk duhen pastruar me presion me materiale pluhur. Sipërfaqet e ashpërsuara qelq-qeramike janë të përhershme dhe kjo do të shpjerë drejt akumulimit të gurëzave.

"NexxZr Glaze Spray" mund dhe të përdoret për indikacione të mëtejshme. Një udhëzues i detajuar për përdorimet e mëtejshme mund ta gjeni në faqen tonë të internetit të "Sagemax".

Është thelbësore të ndiqni parametrat e djegies të përcaktuara në këtë manual. Referojuni edhe informacionit për ekspozimin në ambientin e punës, transportin dhe specifikimet e ruajtjes në fletën e sigurisë teknike.

Parametrat e djegies

Djegia e 1^{-të} (djegia e difuzionit)

Temperatura në gjendje pasive	Koha e mbylljes	Norma e nxehtjes	Temperatura e djegies	Koha e mbajtjes	Norma e nxehtjes	Temperatura e djegies	Koha e mbajtjes	Vakuum	Ftohja afatgjatë	Norma e ftohjes
B	S	t _∇	T ₁	H ₁	t _∇	T ₂	H ₂	V	L	t _L
°C	min	°C/min	°C	min	°C/min	°C	min	°C	°C	°C/min
400	01:00	40	820	05:00	20	920	02:00 - 05:00	jo	450	20-80*

* Në varësi të madhësisë së skeletit

Në varësi të tipit të furrës, temperatura e djegies mund të rregullohet me ± 5°C, maks. me ± 10°C.

Djegia e 2^{-të} (djegia e individualizimit)

Temperatura në gjendje pasive	Koha e mbylljes	Norma e nxehtjes	Temperatura e djegies	Koha e mbajtjes	Vakuum	Ftohja afatgjatë	Norma e ftohjes
B	S	t _∇	T	H	V	L	t _L
°C	min	°C/min	°C	min	°C	°C	°C/min
400	01:00	50	920	01:00 - 03:00	jo	450	20-80*

* Në varësi të madhësisë së skeletit

Në varësi të tipit të furrës, temperatura e djegies mund të rregullohet me ± 5°C, maks. me ± 10°C.

Djegia alternative

Temperatura në gjendje pasive	Koha e mbylljes	Norma e nxehtjes	Temperatura e djegies	Koha e mbajtjes	Vakuum	Ftohja afatgjatë	Norma e ftohjes
B	S	t _∇	T	H	V	L	t _L
°C	min	°C/min	°C	min	°C	°C	°C/min
400	01:00	40	920	02:00 - 05:00	jo	450	20-80*

* Në varësi të madhësisë së skeletit

Në varësi të tipit të furrës, temperatura e djegies mund të rregullohet me ± 5°C, maks. me ± 10°C.



Prodhuesi

Elaboro GmbH
Hagenower Strasse 73
19061 Schwerin, Gjermani
P +49 385-399 33 00
F +49 385-399 33 02
E info@elaboro.de
www.elaboro.de

Distributor

AB Ardent
Generatorgatan 8
19560 Arlandastad, Suedi
P +46 8594 412 57
E info@sagemax.com

sagemax.com

CE 0297

RX only

Vetëm për përdorim stomatologjik

Ky material është zhvilluar vetëm për përdorim në stomatologji dhe duhet përpunuar në përputhje me udhëzimet. Nuk mbajmë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga keqpërdorimi apo mosrespektimi i udhëzimeve. Përdoruesi është përgjegjësi i vetëm për testimin e materialit për përshtatshmëri për çfarëdo qëllimi që nuk përcaktohet shprehimisht tek udhëzimet. Kjo vlen edhe për rastet kur materialet përzihen apo përdoren së bashku me produkte nga kompani të tjera.

© 2020 Sagemax Bioceramics, Inc.
"Sagemax NexZr" është markë e regjistruar tregtare e "Sagemax Bioceramics, Inc."
SQ/2020-09/Rev.2

sagemax®